



RREGULLORE E BRËNDSHME E REVISTËS "JETA JURIDIKE"

Neni 1 Natyra dhe Qëllimi i Revistës

1.1 Revista "Jeta Juridike" është revistë shkencore me karakter juridik, organ i Shkollës së Magjistraturës që botohet nën drejtimin dhe kujdesin e këtij institucioni.

1.2 Revista "Jeta Juridike", është revistë periodike tremujore, që botohet në gjuhët shqip e shoqëruar edhe me një përmbledhje të artikujve në anglisht.

1.3 Botimi i revistës synon të plotësojë literaturën juridike me njohuri praktike dhe teorike në ndihmë të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, juristëve dhe studentëve të fakulteteve të drejtësisë në vend, të jetë një tribunë e diskutimeve dhe debatit juridik, të japë informacion mbi të rejtat në legjislacion, të ofrojë njohuri mbi institute të së drejtës nën një vështrim krahasues, si dhe të japë një informacion për veprimtaritë e Shkollës së Magjistraturës në fushën e Trajnimit Vazhdues dhe të Trajnimit Fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

1.4 Të drejtën për botim në Revistën " Jeta Juridike" e kanë të gjithë Juristët, që me veprimtarinë e tyre kanë kontribuar në sistemin e drejtësisë, gjyqtarët, prokurorët, kandidatët për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, si dhe autorë nga profesione të tjera në shërbim të sistemit të drejtësisë.

Neni 2 Përmbajtja dhe struktura e Revistës

2.1 Përmbajtja e Revistës duhet të ketë përgjithësisht të gjithë elementët e një Reviste Shkencore, si përsa i përket formës, ashtu edhe përmbajtjes. Shkrimet duhet të paraqiten si artikuj jo më shumë se 12 faqe dhe jo më pak se 7 faqe, përveç Rubrikës Debat Juridik e cila mund të ketë edhe opinione më të shkurtëra. Një aneks i kësaj Rregullore do të bëjë publik kërkesat teknike që kanë të bëjnë me shkrimin dhe formën e materialeve të dorëzuara për botim.

2.2 Revista duhet të ketë si rregull, strukturën e mëposhtme:

- Rubrika I – 2-3 Artikuj teorikë;
- Rubrika II – Opinione dhe Debat Juridik – 1-2 shkrime;

- Rubrika III – Njohje me legjislacionin e ri – 1-2 artikuj;
- Rubrika IV – Njohje me praktikën gjyqësore – 1-2 artikuj;
- Rubrika V – Njohje me përvojën ndërkombëtare – 1 artikull;
- Rubrika VI – Shkrime nga juristë të rinj – 1-2 artikuj;
- Rubrika VII – Aktivitete të Shkollës së Magjistraturës;
- Rubrika VII – Përmbledhja e artikujve në anglisht.

2.3 Çdo artikull duhet të jetë i shoqëruar me një përmbledhje të materialit një faqe deri në një faqe e gjysmë, e cila do të përkthehet në anglisht.

2.4 Në botimin e revistës duhet të synohet që të ndiqet rregulli që 2/3 e shkrimeve të jenë përgatitur nga autorë me tituj e grada shkencore. Gjithsesi ky numër nuk duhet të bjerë nën ½-ën.

2.5 Çdo artikull apo material duhet të strukturojë qartë: hyrjen ku të shpjegohet qëllimi i temës, përshkrimin/trajtimin e ndarë në nënçështje sipas problematikës së trajtuar, konkluzionet dhe bibliografinë.

2.6 Çdo artikull që botohet në Revistën “Jeta Juridike” nuk duhet të jetë botuar më parë në libër, tekst, revistë apo botim tjetër, si dhe nuk duhet të botohet në të ardhmen në ndonjë organ tjetër.

2.7 Me qëllim që të krijojë mundësinë e botimeve për sa më shumë autorë, duhet të zbatohet rregulli që një autor nuk mund të shkruajë në dy numra të njëpasnjëshëm të revistës.

Neni 3 Veprimtaria dhe organet drejtuese

3.1 Revista e ushtron veprimtarinë e saj përmes mbledhjeve të Redaksisë, të cilat mblidhen të paktën 1-2 herë për çdo numër që botohet.

3.2 Redaksia është një organ vendimmarrës që përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët propozohen nga Drejtori i Shkollës dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës dhe një Redaktor teknik.

3.3 Anëtarët e Redaksisë duhet të zgjidhen nga radhët e personaliteteve me tituj dhe grada shkencore, me përjashtim të Drejtorit të Shkollës i cili është gjithmonë anëtar i redaksisë. Kryeredaktori i Redaksisë duhet të ketë titullin Prof. Dr.

3.4 Anëtarët e Redaksisë duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që të përfshihen të gjitha degët e së drejtës: disiplinat e së drejtës civile, të së drejtës penale, të së drejtës publike, administrative, kushtetuese, e të tjera.

Neni 4 Kompetencat e Redaksisë

4.1 Anëtarët e Redaksia e Revistës kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Të bëjnë përpjekje për të grumbulluar dhe porositur materiale dhe artikuj për botim;
- Të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e redaksisë duke siguruar jo vetëm pjesëmarrjen por edhe aktivizimin e plotë në dhënien e mendimeve dhe leximin e materialeve që do të seleksionohen për botim. Mungesa e pajustificuar më shumë se në dy herë mbledhje rresht sjell zëvendësimin e tyre me një kandidatë tjetër;
- Të diskutojnë për artikujt duke caktuar të paktën dy recensentë për çdo artikull, në varësi të fushave juridike ku është specializuar secili prej anëtarëve të saj bën redaktimin shkencor të materialeve të sjella për botim;
- Të përgatisin artikuj për botim të paktën një herë në vit;
- Të bëjë përpjekje për gjetjen e fondeve dhe financimeve për botimin e revistës;
- Të bëjë përpjekje për rritjen e abonimeve nga ana e institucioneve të drejtësisë në bashkëpunim me ZABGJ-në.

4.2 Redaktorja teknike e Redaksisë emërohet nga Drejtoria e Shkollës nga radhët e sekretarisë shkencore të Shkollës së Magjistraturës që janë diplomuar si juristë dhe kanë eksperiencë në fushën e publikimeve shkencore.

4.3 Redaktorja teknike ka këto të drejta dhe detyra:

- Të grumbullojë artikujt dhe materialet;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shkollës të fiksojë takimet dhe mbledhjet e redaksisë së revistës duke bërë njoftimet përkatëse të paktën tre javë para;
- Të dërgojë kopje elektronike dhe fizike të të gjithë artikujve tek çdo anëtar i redaksisë të paktë dy javë para mbledhjes së redaksisë;
- Në bashkëpunim me Kryeredaktorin/en e revistës dhe me drejtorinë të caktojë dy recensentë për çdo artikull, sipas fushave që mbulon çdo anëtar dhe t'ua njoftojë këtë gjë anëtarëve;
- Të mbajë procesverbalet e mbledhjeve të redaksisë dhe të përpilojë aktet dhe vendimet e para prej saj;
- Të ketë komunikim të rregullt me çdo autor për vendimet e Redaksisë, duke ruajtur konfidencialitetin e diskutimeve dhe të debateve në mbledhje. Shkelja e këtij rregulli sjell si sanksion vërejtje me paralajmërim dhe nëse përsëritet largim nga detyra.
- Të mbajë kontakte të rregullta me shtëpinë botuese, përkthyesit, redaktorin gjuhësor, specialistin e faqesjes, etj duke respektuar rregullat dhe procedurat publike në bashkëpunim edhe me Zyrën e Financave.
- Të raportojë për tematiken e ezauruar në numrat e mëparshëm, që të mos të ketë përsëritje të temave e problematikës së trajtuar në numrat pasardhës.

4.4 Të dërgohet versioni i fundit i faqosur i Revistës për anëtarët e Redaksisë para se të botohet.

Neni 5 Autorësia dhe e drejta e pronësisë

5.1 Artikulli nuk duhet të jetë i botuar dhe bërë publik më parë në ndonjë formë apo mënyrë tjetër dhe nuk mund të ribotohet më pas, pas botimit të tij në revistën "Jeta Juridike".

5.2 Revista përfaqëson një vepër kolektive të botuar nën drejtimin e Shkollës së Magjistraturës e cila respekton të drejtat morale jopasurore të autorëve të shkrimeve.

5.3 Pas botimit të shkrimeve dhe artikujve në Revistën "Jeta Juridike" çdo e drejtë ekonomike që lidhet me to i kalon Shkollës së Magjistraturës në mënyrë të përhershme, sepse të drejtën e pronësisë mbi revistën dhe materialet e botuar në numrat e saj e gëzon Shkolla e Magjistraturës.

5.4 Pas dorëzimit të materialit për botim autorët, nënshkruajnë një deklaratë që janë dakord me Rregulloren e revistës, dhe nëse, artikujt e tyre miratohen nga redaksia për botim, nënshkruajnë kontratën e botimit.

Neni 6 Financimi i revistës

6.1 Revista "Jeta Juridike" botohet nga Shkolla e Magjistraturës me fondet e saj që burojnë nga buxheti i shtetit, me të ardhurat e grumbulluara nga shitjet dhe abonimet, si dhe donacionet e ofruara nga donatorë vendas dhe të huaj.

6.2 Bordi i redaktorëve të Revistës përcakton dhe numrin e revistave që do të jepen falas.

ANEKS

ME RREGULLAT TEKNIKE TË PARAQITJES SË ARTIKUJVE

SHKENCORE

1. Në Revistën Shkencore të Shkollës e Magjistraturës “Jeta Juridike”, mund të botohen vetëm artikujt të cilët trajtojnë probleme ligjore të lidhura ngushtë me praktikën gjyqësore dhe juridike kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo do të thotë, që artikujt me karakter publicistik, historik dhe tërësisht teorikë, të pa ilustruar me praktikë gjyqësore nuk janë në objektin dhe qëllimin e botimit të revistës.
2. Artikulli duhet të prezantojë një punë studimore, kërkimore, shkencore dhe të evidentojë elementë të qartë të origjinalitetit.
3. Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:
 - 3.1 Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere.
 - 3.2 Të vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe në fund të emrit të vendoset një referencë (footnote), ku të jepet pozicioni dhe profesional aktual i tij/saj.
 - 3.3 Poshtë titullit të artikullit, në krye të shkrimit me një paragraf të veçantë të jepet: përmbajtja e artikullit duke radhitur të gjitha nënçështjet.
 - 3.4 Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa nënçështje në varësi të tematikës që shtron;
 - 3.5 Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij, parë në këndvështrimin e interesave të Shkollës së Magjistraturës dhe të praktikës gjyqësore.
 - 3.6 Të gjithë titujt e nënçështjeve të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik” “Arial 12”. Datat të shkruhen sipas modelit: Data – Muaji – Viti, titujt e nënçështjeve do të paraprihen nga numrat 1.1, 2.1, 3.1 etj,
 - 3.7 Në fund të artikullit duhet të vendoset një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerimet apo Konkluzionet.
 - 3.8 Çdo artikull duhet të ketë të evidentuar edhe Bibliografinë. Çdo artikull duhet të ketë të paktën 15 referenca, vepra dhe vendime gjyqësore.
4. Grumbullimi i materialeve bëhet mbi bazën e tematikës dhe duhet të orientohet në dy burime:
 - Burimi teorik dhe
 - Burimi praktik.

Çdo material konkret teorik skedohet në mënyrë problemore dhe në materialet praktike shtrohet problemi, jepet zgjidhja ligjore, opinionet mbi këtë zgjidhje dhe konkluzionet.

5. Çdo artikull duhet të ketë footnote-a dhe referenca për çdo material dhe autor që ka studiuar dhe referuar duhet vendosur në formë citati, në thonjëza, shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë. Footnote-a duhet të shkruhet me shkrim "Times New Roman 10" dhe të përmbajë: titullin e veprës, autorin, shtëpinë botuese, datën dhe vendin e botimit, faqen nga është marre citati. Nëse autori është konsultuar me një site interneti duhet të shënohet edhe data e aksesueshmërisë: p.sh. akses më 10 Maj 2008. Në fund të footnote-s vendoset pike dhe footnote-a jepet me « Justify ».

6. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 10 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike, që konvertohen në po aq faqe reviste.

7. Shkrimi i artikullit duhet të jetë "Arial 12" me "Spacio 1" dhe i gjithë teksti të jetë "Justified".

8. Artikulli duhet të respektojë elementët gramatikorë dhe gjuhësorë dhe të jetë i shkruar me "ë" dhe "ç".

9. Çdo artikull duhet të ketë jo më pak se 7 – 10 raste të praktikës gjyqësore për ilustrim, të shoqëruar me referencat përkatëse në vendimet e gjykatës. Trajtimi i përmbajtjes së vendimit do të jetë përgjithësisht në ligjëratë të zhdrejtë, do të jepet numri dhe data e vendimit, gjykata përkatëse, palët dhe objekti i padisë apo i gjykimit. Të bëhet kujdes që emrat e palëve në të jenë të vendosura me initiale. Përmbajtja e vendimit gjyqësor që është në fuqi mund të analizohet dhe diskutohet, duke dhënë opinione dhe analiza ligjore, por duke shmangur konkluzionin me termat që "...vendimi është i gabuar, i padrejte apo i paligjshëm". Qëndrimi i autorit dhe mendimi i shprehur prej tij mund të jetë i ndryshëm apo i kundërt me atë të dhënë nga vendimi, por ai duhet të jepet nga pikëpamja doktrinare mbi problemin që analizohet dhe jo e lidhur me vendimin. ***Është shumë e rëndësishme që autorët të zbatojnë rregullat etike të respektimit të personave, institucioneve dhe akteve që ato kanë kompetencë të nxjerrin.***

10. Për të nxitur debatin lidhur me çështje praktike dhe teorike, cilësinë e shkrimit dhe arsyetimit ligjor gjyqësor, revista e Shkollës ka një Rubrikë të titulluar "Debat Juridik", ku mund të jepen opinione personale mbi çështje juridike. Opinionet mund të jenë 3-8 faqe. Kjo rubrikë mund të organizohet me një ose disa opinione të disa autorëve për të njëjtën çështje. Kur opinionin është vetëm i një autori duhet të jetë të paktën 8 faqe.

Prof. dr. Mariana SEMINI

D R E J T O R E